Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Blerina Huruglica	**30.01.2024**	**12.02.2024**	**2024/0069**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 24.01.2024, **OE "PLUS TRADE L.L.C."** ka parashtruar ankesë me nr: **2024/0069**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë G**OE "Labinot M. Krasniqi B.I & Fati Security SHPK."** lidhur me aktivitetin e prokurimit: "**Mirembajtja e ndriçimit publik ne Komunen e Fushe Kosoves**" me nr. të prokurimit: **"612-23-13928-2-2-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 1**20,000.00 €**.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 Q.ellimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi,

Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve si dhe

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës

Neni 61 Tenderet Jo-Normalisht të Ulët

Neni 64 Dështmitë e kërkesave

Neni 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale

Gjithashtu dhe dizpozitat përkatëse të Rregulloreve të KRPP-së.

Me date 26.12.2023 OE Plus Trade LLC ka dorëzuar oferten për projektin : Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Komunën e Fushë Kosovës.

Nga AK, fillimisht me daten 10.01.2024 permes platformes elektronike është publikuar njoftimin mbi vendimin per dhenie te kontrates OE Labinot Krasniqi Bl dhe Fati Security, përkatësisht Letrën standarte për tenderuesin e pasukseshem dhe në bazë të kësaj kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë AK-së.

Ne nuk jemi të kënaqur me vleresimin nga AK-ja, pasi ka vlerësuar kërkesen tonë të pabazuar edhe përkundër të gjitha fakteve dhe dështmive të prezentuara në Kërkesën tone.

Ne ushtrojmë këtë ankesë pranë OSHP-së për shkak se AK- Kuvendi i Komunës së Fushë Kosovës:

Në mënyrë të kundërligjshme na ka shpallur tenderues i pasuksesshëm pasi që i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-së) të vendosura në Njoftim për Kontratë (NJK) dhe në dosjen e Tenderit(DT).

Në mënyrë të kundërligjshme ka rekomanduar për kontratë GOE të papërgjeshëm dhe të papërshtatshëm i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e Autoritetit Kontraktues (AK-së) të vendosura në Njoftim për Kontratë (NJK) dhe në dosjen e Tenderit(DT).

Sqarojmë në mënyrë të detajuar pretendimet tona për përgjegjshmërinë tonë dhe prezentojmë dështmit mbi mospërmbushjen e kërkesave të vendosuar nga AK-ja në Njoftim për Kontratë (NJK) dhe në dosjen e Tenderit(DT).nga GOE të rekomanduar dhe dy të tjerët.

Duke krahasuar kërkesat në DT dhe ofertën e dorëzuar nga grupi i OE-ve te rekomanduar per kontrate, kemi verejtur që oferta e tyre nuk përmbush këto specifikime teknike: Bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2:

Prezentojmë fakti 1:

Duke iu referuar pikës 1, sipas FTD-së të kërkuara nga AK-ja, ku kemi hijezuar me ngjyrë të kuqe është kërkuar të paraqitet lista e projekteve duke saktësuar produktet e përfshira , gjë që tek ky GOE nuk është prezentuar në formën e kërkuar nga AK-ja.

Prova 1. Lista e kontratave të realizuara (Kërkesa sipas FTD-së)

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 180 000.00 euro.Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar furnizime te natyres se ngjajshme.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1.Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkatese ose proceset e pranimeve per projektet e perfunduara – kopje.**

Prova 1. Lista e kontratave të realizuara të paraqitura nga GOE të rekomanduar për dhënie të kontratës nuk është sipas specifikave të përshkruara në FTD.

TONI

Lista e kontratave te realizuara nga Kompania N.N.P."Toni" ne tri vitet e fundit : 2020,2021 dhe 2022.

Numri rendor	Emri i projektit	Numri i prokurimit ose kontratës	Data e nënshkrimit	Vlera e kontratës	Plani dinamik	Data e përfundimit	Vendi i realizimit te projektit	Referenca ose pranimi teknik - Po/Jo	Autoriteti Kontraktues
1.	Rregullimi I ndriçimit public	Nr.Iden.617-2018-019-121	29.05.2018	55,407.50 Te realizuara per ,20,21: 43,020.00	3 vite	29.05.2021	Shtimje	pjesrisht	Komuna e Shtimjes
2.	Mirëmbajtja e ndriçimit publik – Vushtrri	Nr. Prok.VU644-18-4455-2-2-1/FA52	23.08.2018	36,717.00 Te realizuara: 27,720.00	2 Vite	22.08.2020	Vushtrri	po	Komuna Vushtrri
3.	"Mirëmbajtja e ndriçimit	Nr, Iden.632-18-003-	27.09.	166,302.30					

Prezentojmë tutje faktin 2:

Poashtu tek pika 2, është kërkuar të prezentohet një pasqyrë tabelare e stafit të angazhuar sipas kërkesës duke paraqitur edhe eksperienca, gjë e e cila mungon ne listen e prezentuar nga GOE i rekomanduar.

Prova 2. Pasqyra tabelare e personelit (Kërkesa sipas FTD-së)

2.Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 6 punetore).Në rast te grupit lideri duhet ti kete min 4 punetore.	**2.Një pasqyrë tabelare e personelit Emrin,Mbiemrin,Profesionin,Eksperienca dhe pozicioni të angazhuar me parakontrate ne kompani , duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga OE**

Prova 2. Pasqyra tabelare e personelit të paraqitura nga GOE të rekomanduar për dhënie të kontratës nuk është sipas specifikave të përshkruara në FTD.

STAFI PUNUES I ANGAZHUAR I KOMPANISË

NR	EMRI E MBIEMRI	POZITA	PROFESIONI	DATA E LINDJES	NR. PERSONAL
1.	Labinot Krasniqi	Pronari	Tek.elektroteknikes	14.05.1983	1010480325
2.	Nazif Nazifi	Menagjer - Inxh.i elektroteknikes	Ing.dipl.elek.-sistemet energjetike	12.05.1971	1016002581

Prezentojmë tutje faktin 3:

Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

3.OE duhet të emëroj menaxherln e projektit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

3.OE në kuadër të stafit me vendim ose deklarate duhet të emëroj menaxherin e projektit i cili duhet të jet inxhinjer i i elektroteknikes ,me së paku tri vite përvojë pune në profesion e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën e punës ,të jet në listën e të punesuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi.

Tek menaxheri i projektit është prezentuar kontrata e punës e lidhur me datë 01.09.2022, dhe me poshtë në po të njëjtin file është prezentuar CV, e cila përfshinë përvojën e punës por për të mbështetur ekspërriencën, kemi vetëm një vërtetim mbi këtë përvojë prezentuar vetëm nga vet kompania OE Labinot Krasniqi që është në konflikt interesi të vërtetohet përvoja e punës ku kontrata e punës është vetëm nga viti 01.09.2022 dhe nuk është prezentuar ndonjë kontratë tjetër ose çfarëdo dokumenti që do të kishte mbështetur CV-në e prezentuar. Duke iu referuar dëshmive dhe dokumenteve të ofruara nga OE e që I kemi pranuar nga AK-ja, nuk ka fakte të prezentuara mbi përmbushjen e kriterit për përvojën e punës.

Prova 3. Kontrata e punës me datë fillimi të punës 01.09.2022

Ne bazë të **Nënit 10**, paragrafi **2**, pika **2.1** edhë **2.2** dhe **Nënit 11** të **Ligjit të Punës, Nr. 03/L-212** I shpallur në **Gazetën Zyrtare** të **Republikës** së **Kosovës**, me **dt.01.12.2010. Punëdhënësi** dhë i **Punësuari**, si subjekt të mardhënjës juridikë të punës, lidhin :

KONTRATË PUNE PËR KOHË TË PA CAKTUAR

Neni 1

Me këtë kontratë N.N.P."TONI" me sëli në Drenas , me **NRF: 810254532** përfaqësuar nga: **Labinot Krasniqi** , drejtor **Punëdhënësi** , lidhë kontratë pune me :**Nazif Nazifi** nga **Kuklibeci-Dragash** me nr.personal **1016002581** ne tekstin e mëtëjshëm : **I Punësuar**.

Neni 2

I punësuari do të kryej detyrat e punës sipas kualifikimit dhë pozitës ne kompani : **Inxhinier i Elektroteknikes, I punësuari** do të punoj sipas nevojave që paraqitën ne kompani dhe krijon mardhënie të punës me page sekundare : Me kohë **të pacaktuar,** duke filluar nga : 01/09/2022. I punësuari është e detyruar të punoi ne realizimin e projekteve te lamisë se se kti profesioni (si ingj.i dip. I elektroteknikes), sa here ka nevojë kompania.

Neni 3

I punësuari do të punoj vetem sipas nevojës së firmës kur angazhohet ne ndonje projekt.Të punësuarit i caktohet paga bazë bruto për punën të cilën e kryen për punëdhënsin, ne lartësi prej: **300.00 euro/muaj** e cila i jepët nga data **01 deri me 05** të muajit vijues dhe e cila varësisht nga puna ne projekt edhe mund **të** rritet.Të punësuarit do ti paguhen edhe kontributet për çdo projekt që do të angazhohet.

Prezentojmë tutje faktin 4:

Sipas kërkesës në FTD, pika 5 dhe 6,

5. OE duhet te ofroj Certifikaten ISO 9001 2015

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

5.IS0 9001 2015 mbi sistemin e menaxhimitte cilesis - kopje me validitet

6. OE duhet te ofroj certifikaten ISO 45001 2018

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

6.ISO 45001 2018 sistemi per menaxhimin e siguris dhe shendetit ne pune - kopje me validitet.

AK-ja në FTD ka kërkuar që të dorëzohen këto Certifkata me dosjen fillestare ashtu që të konsiderohet i përgjegjeshëm dhe që i përmbush këto kritere për të vazhduar vlerësimin e ofertës në tërësi, por që në këtë rast, AK-ja ka vazhduar në kërkesë për plotësim të dosjes pas dorëzimit fillestar të bërë në e-prokurim me datë 26.12.2023, pasi ky GOE, nuk ka dorëzuar Certifikatën sipas pikës 6 të FTD-së

GOE ka dorëzuar (pas dorëzimit të ofertës fillestare) një document çertifikatë referuar kërkesës Letër standarte e kërkesës për sqarimin e tenderit.

Sipas FTD-së, referuar pikave a,b,c dhe d, eshte kerkuar Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është

përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. **një deklaratë e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; b. **një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët**, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. **një deklaratë të nënshkruar** nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Referuar kesaj pike, te gjithe anetaret nuk jane te pershtatshem pasi qe nuk kane prezentuar deshmine per pershtatshmerin e tyre konforme dosjes se tenderit, andaj referuar certifikates ISO sipas pikes 5 dhe 6 OE Labinot Krasniqi nuk permbush kete kriter, andaj nuk mundet te sigurohet qe ky OE i propozuar mund te ofroj realizimin e kontrates sipas standarteve te kerkuara. Labinot Krasniqi eshte lideri i grupit ne kete rast ndersa ky OE nuk eshte i certifikuar sipas kerkeses pikes 6 te FTD-se, referuar tutje si fakti 4.

Ne perputhje me nenin 40 par 4 nderlidhur me nenin 40.7 te Rregullores nr 01/2022 per Prokurim Publik thuhet se :

Tenderi do te konsiderohet i pergjegjshem kur

a) Eshte ne pajtueshmeri ne nga aspketi administrative me kerkesat formale te Dosjes se Tenderit b) Eshte ne pajtueshmeri me termet teknike, me pershkrimin, kerkesat dhe specifikimet e percaktuara te Dosjes se tenderit

c) Eshte dorezuar nga operatori ekonomik qe permbushe kriteret e perzgjedhjes te percaktuara ne Dosjen e Tenderit.

Përpos kësaj, lidhur me këtë është **edhe interpretimi i KRPP i dates 22.06.2023 nr.22** që sqaron këtë:" Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), **atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi.** Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, **atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla,** në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit"

Pra ky grup i OE qe eshte propozuar per dhenie te kontrates eshte i papergjeshem, pasi nuk eshte permbushur kerkesa sipas dosjes se tenderit nga te dy OE, meqe rast edhe certifikata e FATI SECURITY, nuk eshte e mundur te arrihet te verifikohet ne webin e trupit certifikues te ISO, pasi nuk ka web aktiv meqe rast rrjedhin dyshime mbi vlefshmerine e kesaj certifkate ky edhe ka skaduar me

18.03.2023 ndersa vazhdimi i saj nuk po arrihet te verifikohet ne web-in e Das System & Services Pvt Ltd, pasi webi i saj nuk eshte aktiv dhe nuk mundet te validohet ky instiucion në IAF(The international Accreditation Forum). Gjithashtu, Çertifikimi ISO 45001:2018 në emër të FATI Security është për një fushë që ka të bëjë me aktivitetet telekomunikuese primare kabllore, aktivitetet e telekomunikimit me wireless, gjë që kjo natyrë e punës nuk është në asnjë pozicion të paramasës së kërkuar për ekzekutim. Andaj, ky kriter mbetet ende i paplotësuar nga GOE i rekomanduar për kontratë, edhe pas kërkesës letër standarte nga AK-ja, andaj edhe ky fakt, përpos fakteve të lartëshënuara, dëshmon mospërmbushjen e kritereve të vendosuara në Dosjen e Tenderit meqë rast duhet të eliminohet ky OE e jo të shpërblehet me kontratë

Prova 4. Kërkesa mbi vërtetimin e validimit të Certifikates ne Das System & Services Pvt Ltd.



Prova 4. Certifikata nga Das System & Services Pvt Ltd per aktivitetet telekomunikuese primare kabllore, aktivitetet e telekomunikimit me wireless

Certificate of Registration

This is to certify that the Occupational Health & Safety Management of

FATI SECURITY

Rr. Xheladin Gashi-Plaku, p.n. 13000 Drenas, Kosovo

Has been successfully assessed & Conforms with the following standard

ISO 45001:2018

Scope of Certification

"PRIMARY CABLE TELECOMMUNICATIONS ACTIVITIES, WIRELESS TELECOMMUNICATIONS ACTIVITIES"

Certificate No. OHS/DAS22/I0046

Initial Registration Date	:	19-03-2022
Issue Date	:	19-03-2022
Surveillance 1 Audit Date	:	19-02-2023
Surveillance 2 Audit Date	:	19-02-2024
Expiry Date	:	18-03-2023
Validity Date	:	18-03-2025

Subject to successful completion of Surveillance Audits

IAS IAF

(Managing Director)

Prezentojmë tutje faktin 5:

AK-ja në DT ka kërkuar që Kopjet e çertifikatave për siguri dhe shëndet në punë të jenë të noterizuara dhe të prezentonen të tilla.

7. OE duhet te ofroj vleresimin e riskut nga nje kompani e licencuar nga MPMS , sipas Ligjit Nr.04L 161 per siguri dhe shendet ne pune .	**7. Deshmi kopja e certifikates per siguri dhe shendet ne pune e noterizuar nga origjinali per punetoret e angazhuar te certifikuar per siguri dhe shendete ne pune si dhe kopja e licences se bashku me raportin e vleresimit nga kompania e licencuar nga MPMS-ja.**

Ne dosjen fillestare te dorezuar ne e-prokurim mungojne Kopjet e çertifikatave për siguri dhe shëndet në punë të jenë të noterizuara , OE ka dorezuar certifikata jo te noterizuara pas kërkesës nga AK-ja Letër standarte, kete deshmi e kemi edhe ne nga casja e marre ne AK. Por ne kerkesen tone per rishqyrtim, duke konstektuar kete pike, AK-ja eshte pergjigjur qe AK-ja i ka kerkuara deshmi shtese 9/3 dhe OE ja ka percjellur pastaj te noterizuara, gjë që nukjanë këto certikafata të noterizuara në qasjen që e ka siguruar për kompanine tonë vet AK-ja, gje qe po aludohet që AK-ja pas kalimit te afatit ligjor per te plotesuar dosjen ose pas kërkesës sonë për rishqyrtim, i ka kerkuar prape dokumente shtese, duke e favorizuar pa te drejte dhe duke i dhene mundesi te kompletoj dosjen pas kalimit te te gjitha afateve.

Prova 5. Formati i certifikates se dorezuar te panoterizuar.

HSK

HSK L.L.C.
Health and Safety at Work
Adresa: Ulpiana C7/n11, 10000 Prishtinë
Kontakti: +386 (0) 49 648 271
+377 (0) 44 168 026 ; +381(0) 38 648 271
e-Mail: info@hsk-ks.com ; www.hsk-ks.com

REPUBLIKA E KOSOVËS

Në bazë të nenit 4, paragrafi 1.3 të Rregullores nr. 02/2014, të datës 14.07.2014, HSK.LLC, Kompani e Licencuar për ushtrimin e punëve profesionale nga Siguria dhe Shëndeti në Punë, me nr të licencës 01/2017, Prishtinë lëshon:

Based on Article 4, paragraph 1.3 of the Regulation no. 02/2014, date 14.07.2014, HSK. LLC a Licenced company for performing profesional work on Health and Safety at work, licence no. 01/2017, Prishtina, issues this:

CERTIFIKATE

Nr.17/09-14643

PËR TRAJNIMIN E PUNËTORIT PËR KRYERJEN E SIGURTË TË PUNËS NGA LËMIA E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË

OF TRAINING FOR THE EMPLOYEES ON HEALTH AND SAFETY AT WORK FOR A SAFE WORK

Emri dhe Mbiemri: *Name and Surname:*	**LABINOT KRASNIQI**
Data e lindjes: *Date of Birth:*	**14.05.1983**
Vendi i lindjes: *Place of birth:*	**DRENAS**
Shteti: *Country:*	**REPUBLIKA E KOSOVËS**
Punëdhënësi: *Employer:*	**LABINOT M. KRASNIQI B.I.**
Profesioni: *Profession:*	**DREJTOR**
Vendi dhe data e mbajtjes së trajnimit: *Place and date of training:*	**PRISHTINË - 28.06.2022**

Kandidati ka përfunduar trajnimin për zbatimin e masave parandaluese, nga Lëmia e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

The candidate has finished the training about implementation of preventive measures on Health and Safety at Work.

Prishtinë:
29.06.2022

HSK llc

kjo oferte nga Grupi i OE-ve te shpallur fitues eshte dashur te konsiderohej si oferte e pa pergjegjshme pasi qe nuk i ploteson kushtet mbi mundesite tekinke dhe/pse administrative. Dhe jo te shpallet fitues ashtu si ka vepruar AK duke shkelur Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale, andaj edhe kerkohet qe te anulohet vendimi per dhenie te kontrates dhe te rishqyrtohet edhe njehere dhe te jemi ne OE i perpgjegjshem perte realizuar kete projekt.

Prezentojmë tutje faktin 6:

Refereruar edhe cmimeve te ofertuar, ky grup i OE, ka ofertuar me cmime jo normalishte te uleta,

Ne baze te Ofertës se prezantuar shihet qarte se O.E i rekomanduar për kontrate ne shumicën e pozicioneve ka çmim jo normalisht te ulet. Ne baze te kësaj mendojmë se Al< ka vepruar ne kundërshtim me nenin 61 te LPP-se dhe te nenit 41 te Rregullore 001/2022. Neni 41 Tenderët Jo- normalisht të Ulët, pasi nuk ka kërkuar sqarime shtesë dhe zbërthim të kostos financiare për këto pozicione

Siq shihet edhe nga oferta per pozicionet si: 3, 5 6 dhe 17 ky OE ka perdorur cmime manipulative te cilat edhe shume lehte jane te verifikueshme ne treg, ku NE ofrojme deshmin mbi cmimet e furnizmit te cilat jane te papranueshme se si i ka paraqitur OE Labinot Krasniqi dhe Fati Security.

Prova 6 . Cmime jonormalishte te uleta te ofertuara nga GOE I rekomanduar per kontrate

3	Furnizimi, transporti dhe montimi i kontaktonit TIP CN 160 A si 380 V i vendosur në orman të grupit matës.	copë	34	30	1,020.00 €
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i bazës së siguresave ORS deri në 160A	copë	10	1	10.00 €
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i AS me shtjellim prej 100-160A.	copë	30	5	150.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i relesë kohore 16A IC Astrologjike ,Siemes,Schneider,Abb ose të ngjashme.	copë	50	15	750.00 €

Te gjitha cmimet e oferuara jane nen cmimin e kostos me perqindje te larte, andaj eshte e pamundurte pranohen keto cmime manipulative.

Siq është prezentuar, kemi mjaftueshem fakte se ky OE është i papërgjeshëm dhe se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore:

Shkelje e nenit 7 të LPP-së ne piken 1 dhe 2 : Trajtimi ne mënyre të barabartë dhe jo-diskriminuese Neni 59 të LPP-së: Nuk është bërë ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimmi 1 tendereve conform këtij neni

Neni 60 të LPP-së: Kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi 1 përgjegjshëm me cmim më të lirë.

Neni 61 të LPP-së: Ndjekja e procedurave per cmime jo normalishte te ulëta.

Perpos ketij grupi te operatove te papergjeshem Labinot Krasniqi dhe Fati Security, eshte i

papergjeshem edhe grupi i OE NNP Ndriqimi dhe Termovision Shpk.

Duke krahasuar kërkesat në DT dhe ofertën e dorëzuar nga grupi i NDRIQIMI dhe TERMOVISION, kemi verejtur që oferta e tyre nuk përmbush këto specifikime teknike: Bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2:

Prezentojmë fakti 1:

Duke iu referuar pikës 1, sipas FTD-së të kërkuara nga AK-ja, ku kemi hijezuar me ngjyrë të kuqe është kërkuar të paraqitet lista e projekteve duke saktësuar produktet e përfshira , gjë që tek ky GOE nuk është prezentuar në formën e kërkuar nga AK-ja.

Prova 1. Lista e kontratave të realizuara (Kërkesa sipas FTD-së)

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 180 000.00 euro.Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar furnizime te natyres se ngjajshme.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1.Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkatese ose proceset e pranimeve per projektet e perfunduara – kopje.**

Prova 1. Lista e kontratave të realizuara të paraqitura nga GOE nuk është sipas specifikave të përshkruara në FTD.

NDËRMARRJA PRIVATE PËR ELEKTRIKË

NDRIQIMI

PRISHTINË

Mobil: 044-260 990
*Xh.log.*13-00-0010012883.11,,BpB' Prishtinë
e-mail: np.ndriqimi@hotmail.com

LISTA E REFERENCAVE

NR	Titulli i kontratës	Viti i nënshkrimit te kontratës	Viti i përfundimit te kontratës	Emri i Blerësit	Vlera totale e kontratës
1	Mirëmbajtja e ndriçimit publik në rrugët e Prishtinës për vitin 2015 – Pjesa II	2015	2016	K.K-Prishtinë	39,057.00
2	Ndërtimi (rregullimi) i ndricimit publik nërrugë: "Skenderbeu", "Brigadat" dhe "Hizri Talla	2016	2016	K.K-Podujevë	47,478.90

Referuar edhe vleres se kerkuar te kontrateve per 3 vitet e fundit ky OE Ndriqimi nuk ka referenca ose pranime te puneve ne vleren e kerkuar si dhe anetari tjeter Termovision te gjitha kontratat i ka te

natures se mirembatjes se nxehmjeve dhe ngrohjes qendrore, andaj edhe nuk eshte ne natyren e punes se kerkuar nga AK, andaj ky grup nuk permbush as piken kryesore te dosjes se tenderit.

Prezentojmë tutje faktin 2:

Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

3. OE duhet të emëroj menaxherin e projektit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

3.0E në kuadër të stafit me vendim ose deklarate duhet të emëroj menaxherin e projektit i cili duhet të jet inxhinjer i i elektroteknikes ,me së paku tri vite përvojë pune në profesion e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën e punës ,të jet në listën e të punësuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi

Tek menaxheri i projektit eshte prezentuar, kontrata e punes dhe me poshte eshte prezentuar CV, e cila perfshine pervojen e punes ne kompanine IBITS qe vertetohet me nje reference nga kjo kompani e cila nuk ka date te leshimit te references, andaj nuk mundemi edhe te validojme se per cilen peirudhe po vertetohet pervoja e punes, por nese shikohet pershkrimi i punes ne CV, kjo kompani nuk ka kete natyre te punes, referuar aktiviteteve te pershkruar ne webin https://arbk.rks-gov.net/

Prova 3. CV e prezentuar nga Menaxheri I projekti

Visar Abdurrahmani CV

An Electrical Engineer with experience in fields of Software Development, Procurement, Electrical Engineering and Urban Lighting projects.

E-mail: visar.abd@gmail.com , Phone: (+383) 44 744 557, Address: Ali Hadri no.25

EXPERIENCE

IBITS LLC, Prishtina (Kosovo) — *Electrical Engineer*

Sep 2019 - Present

- Designed and executed electrical projects for medium and low voltage projects, ensuring compliance with safety standards and regulations.
- Managed and supervised electrical installations for medium and low voltage systems, overseeing the work of contractors and technicians to maintain high-quality standards.
- Collaborated with technical teams to plan and implement electrical components, ensuring seamless integration on medium and low voltage level systems.
- Played a key role in contracting necessary materials for projects, evaluating supplier capabilities, product quality and pricing to ensure timely and cost-effective material acquisition.

SKILLS

Electrical Engineering related skills:

Electrical System Design, Circuit Analysis, Power Distribution, AutoCAD, Electrical Safety, Technical Analysis, Wiring and Cabling, MATLAB, Power Factory, Project Management, Instrumentation, Energy Efficiency, Maintenance.

Procurement related skills:

Negotiation Skills, Time Management Skills, Attention to Detail, Market Awareness, Ethical and Compliance Awareness.

Other Skills: Fast Adaptability and flexibility, Creativity, Multitasking, Planning and Problem-solving, Persistence, Team Collaboration, Analytical Thinking, Communication Skills.

Prova 3. Refernca e prezentuar nga Menaxheri I projektit

VËRTETIM

iBits LL.C.
Tel.044-426592
e-mail; viqan.abd@gmail.com
Tel.044-426592
Nr.Unik 81135047
Prishtinë Rr.Ali Hadri, 7

Për: Visar Abdurrahmai
Nr.Personal:1231688257

Me anë të këtij vërtetimi deklarojmë se Visar Abdurrahmani me Nr.Personal 1231688257 është i angazhuar në kompaninë tonë iBits LL.C. - Prishtinë nga data Shtator 2019 në pozitën Inxhinier i Elektroteknikës.

Visar Abduhrrahmani punon me përkushtim të plotë në kryrjen e detyrave të dhëna dhe marrjen e përgjegjesive të plota në atë për çfarë është i ngarkuar. Aftesitë e tij bashkëpunimi janë shumë të mira dhe me rezultate.

Ju lutem që për çdo informat shtes mos hezitoni të na kontaktoni

IBits LL.C.

IBITS L.L.C.-PRISHTINË

Prova 3. Te dhenat mbi aktivitetin e kompanise IBits LLC

iBits L.L.C.

Regjistrimi i ndryshimeve në biznes

Lista e Taksave

Hapja e Llogaris e-Regjistri i Biznesit

Libri i Klasifikimit te Veprimtarive Ekonomike (Nace Rev2)

Emri i biznesit	iBits L.L.C.
Emri tregtar	iBits
Lloji biznesit	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuara
Numri unik identifikues	811350470

Aktivitet/et

ARBK

Kodi	Përshkrimi	Tipi
6201	Aktivitetet e programimit kompjuterik	Aktiviteti kryesor i biznesit
6209	Teknologjia tjetër informative dhe aktivitetet shërbyese kompjuterike	Aktiviteti sekondar

Duke iu referuar dëshmive dhe dokumenteve të ofruara nga OE e që kemi pranuar keto dokumnetet nga AK-ja, nuk ka fakte te prezentuara mbi permbushjen e kriterit per pervojen e punes.

Prezentojmë tutje faktin 3:

Sipas kërkesës në FTD, pika 5 dhe 6,

5. OE duhet te ofroj Certifikaten ISO 9001 2015

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

5.ISO 9001 2015 mbi sistemin e menaxhimit te cilesis - kopje me validitet

6. OE duhet te ofroj certifikaten ISO 45001 2018

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

6.ISO 45001 2018 sistemi per menaxhimin e siguris dhe shendetit ne pune – kopje me validitet.

Sipas FTD-SE, referuar pikave a,b,c dhe

d, eshte kerkuar Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. **një deklaratë e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës; b. **një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët**, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. **një deklaratë të nënshkruar** nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit; dhe d. Të gjitha anëtarët e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.

Referuar kesaj pike, te gjithe anetaret nuk jane te pershtatshem pasi qe nuk kane prezentuar deshmine per pershtatshmerin e tyre konforme dosjes se tenderit, andaj referuar certifikates ISO sipas pikes 5 dhe 6 OE NNP Ndriqimi nuk permbush kete kriter, andaj nuk mundet te sigurohet qe ky OE i propozuar mund te ofroj realizimin e kontrates sipas standarteve te kerkuara. OE NNP Ndriqimi eshte lideri i grupit ne kete rast ndersa ky OE nuk eshte i certifikuar sipas kerkeses pikes 5 dhe 6 te FTD-se.

Lidhur me këtë është edhe interpretimi i KRPP i dates 22.06.2023 nr.22 që sqaron këtë: " Në rast të kontratave për furnizime, kur Autoriteti Kontraktues kërkon dëshmi Certifikata të hartuara nga institutet zyrtare për kontrollimin e cilësisë që vërtetojnë përshtatshmërinë e produkteve që qartazi mund të identifikohen duke u bazuar në specifikimet dhe standardet përkatëse (neni 69, paragrafi 2, nen paragrafi 2.5 i LPP), atëherë një dëshmi e tillë mjafton të sillet nga anëtari i grupit i cili do të kryej furnizimin, në mënyrë që të konsiderohet se kërkesa është përmbush nga grupi si tërësi. Pa varësisht nga kjo, në rast se të gjithë anëtarët e grupit marrin pjesë në ekzekutimin e kontratës duke liferuar furnizime të prodhuara nga vetë ato, atëherë të gjithë anëtarët e grupit duhet të jenë të pajisur me certifikata të tilla, në mënyrë që AK të sigurohet se produktet e furnizuara janë të cilësisë sipas standardeve përkatëse të specifikuara në dokumentet e tenderit"

Pra ky grup i OE eshte i papergjeshem, pasi nuk eshte permbushur kerkesa sipas dosjes se tenderit nga te dy OE, meqe rast edhe certifikatat e Termovision, janë të papranueshme per shkak qe ky OE mirret me nje veprimtari tjeter e qe nuk ka te bej me ndricim publik sipas kerkeses se dosjes se tenderit ku kerkohet qe ne 3 vitet e fundit te kete pune te natyres se ngjashme e qe ky OE nuk e ploteson kete kriter.

Ne perputhje me nenin 40 par 4 nderlidhur me nenin 40.7 te Rregullores nr 01/2022 per Prokurim Publik thuhet se :

Tenderi do te konsiderohet i pergjegjshem kur

a) Eshte ne pajtueshmeri ne nga aspketi administrative me kerkesat formale te Dosjes se Tenderit b) Eshte ne pajtueshmeri me termet teknike, me pershkrimin, kerkesat dhe specifikimet e percaktuara te Dosjes se tenderit

c) Eshte dorezuar nga operatori ekonomik qe permbushe kriteret e perzgjedhjes te percaktuara ne Dosjen e Tenderit.

Prezentojmë tutje faktin 4:

Refereruar edhe cmimeve te ofertuar, ky grup i OE, ka ofertuar me cmime jo normalishte te uleta,

Ne baze te Ofertës se prezantuar shihet qarte se OE ne shumicën e pozicioneve ka çmim jo normalisht te ulet. Ne baze te kësaj mendojmë se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 61 te LPP- se dhe te nenit 41 te Rregullore 001/2022. Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët, pasi nuk ka kërkuar sqarime shtesë dhe zbërthim të kostos financiare për këto pozicione:

Siq shihet edhe nga oferta Per pozicionet si: 3,5,6,7,22,dhe 23 ky OE ka perdorur cmime manipulative te cilat edhe shume lehte jane te verifikueshme ne treg, ku NE deshmojme mbi cmimet e furnizmit te cilat jane te papranueshme se si i ka paraqitur OE NNP Ndriqimi dhe Termovision.

Prova 4 . Cmime jonormalishte te uleta te ofertuara nga GOE.

3	Furnizimi, transporti dhe montimi i kontaktonit TIP CN 160 A si 380 V i vendosur në orman të grupit matës.	copë	34	10	340.00 €
4	Furnizimi, transporti dhe montimi i bazës së siguresave ORS deri në 160A	copë	10	1	10.00 €
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i AS me shtjellim prej 100-160A.	copë	30	1	30.00 €
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i relesë kohore 16A IC Astrologjike ,Siemes,Schneider,Abb ose të ngjashme.	copë	50	5	250.00 €
7	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafove për trupat ndriques LED për -50W.	copë	50	15	750.00 €
			10	3	
22	Furnizimi, transporti dhe montimi i papuçeve, shticne, shtrëngues gëzhojave për lidhjen e kabllove në orman për 4x16mm² Al-Cu	copë	20	0.1	2.00 €
23	Furnizimi, transporti dhe montimi i tërheqëses së kabllit bistek në seksion 2x16mm²	copë	200	0.3	60.00 €

Te gjitha cmimet e oferuara jane nen cmimin e kostos me perqindje te larte, andaj eshte e pamundur te pranohen keto cmime manipulative. Perpos kesaj, qe le te konkludohet qe keto cmime jane manipulative , ku OE ka paraqitur edhe cmime abnormalisht te larta per poz 7 dhe 8 duke ofertuar me marzhe te larta marramendese te fitimit duke kundershtuar edhe nenin 1 te LPP per shfrytezimin efikas te mjeteve publike.

Prova 4 . Cmime jonormalishte te larta te ofertuara nga GOE.

7	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafove për trupat ndriques LED për -50W.	copë	50	15	750.00 €
8	Furnizimi, transporti dhe montimi i trafove për trupat ndriques LED për -100W.	copë	20	20	400.00 €

Siq është prezentuar, kemi mjaftueshem fakte se ky OE është I papërgjeshëm dhe se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore:

Neni 1 të LPP-së: të sigurojë mënyrën më efikase, më transaparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit tëfondeve publike, burimeve publike dhe të gjitha burimeve tjera

Shkelje e nenit 7 të LPP-së ne piken 1 dhe 2 : Trajtimi ne mënyre të barabartë dhe jo-diskriminuese

Neni 59 të LPP-së : Nuk është bërë ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimmi I tendereve conform këtij neni

Neni 60 të LPP-së: Kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi I përgjegjshëm me cmim më të lirë.

Neni 61 të LPP-së: Ndjekja e procedurave per cmime jo normalishte te ulëta

Perpos ketij grupi te operatove te papergjeshem Labinot Krasniqi dhe Fati Security, grupi i OE NNP Ndriqimi dhe Termovision Shpk, kemi edhe OE ETM GROUP Shpk qe edhe ky eshte nje OE i papergjeshmen ne oferten e ofertuar sipas kerkesave te dosjes se tenderit.

Duke krahasuar kërkesat në DT dhe ofertën e dorëzuar nga **OE ETM GROUP SHPK,** kemi verejtur që oferta e tyre nuk përmbush këto specifikime teknike: Bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2:

Prezentojmë fakti 1:

Duke iu referuar pikës 1, sipas FTD-së të kërkuara nga AK-ja, ku kemi hijezuar me ngjyrë të kuqe është kërkuar të paraqitet lista e projekteve duke saktësuar produktet e përfshira , gjë që tek ky OE nuk është prezentuar në formën e kërkuar nga AK-ja.

Prova 1. Lista e kontratave të realizuara (Kërkesa sipas FTD-së)

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional:** **1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 180 000.00 euro.Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar furnizime te natyres se ngjajshme.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare* **1.Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkatese ose proceset e pranimeve per projektet e perfunduara – kopje.**

Prova 1. Lista e kontratave të realizuara të paraqitura nga OE nuk është sipas specifikave të përshkruara në FTD.

ETM GROUP

ETM Group sh.p.k.
Rr. "Hamdi Grajqevci", nr. 11, Fushë Kosovë
Tel: +383 49 555 686
info@etmgroup-ks.com
www.etmgroup-ks.com
NRB: 810199944
NRF: 601694153
Nr. TVSH: 330337396

Lista e kontratave gjatë viteve 2020-2023

Nr.	Investitori	Kontakt	Titulli i kontratës	Nr. identifikues i kontratës	Data	Çmimi i kontratës
1	L&B CAPITAL	+38349500509	Ndertimi i linjes 0,4 kV	N/A	15.10.2020	2,535.00 €

Referuar edhe vleres se kerkuar te kontrateve per 3 vitet e fundit ky OE ETM Group nuk ka referenca ose pranime te puneve ne vleren e kerkuar qe deshmojne pranimin ose perfundimin e kontratave ose puneve te kesaj natyre te kerkuar per ndricimin publik, kontratat e perfunduara nuk kane pranime teknike ose referenca andah nuk konsiderohen te perfunduara dhe si baze andaj ky grup nuk permbush as piken kryesore te dosjes se tenderit.

Prezentojmë tutje faktin 2:

Poashtu tek pika 2, është kërkuar të prezentohet një pasqyrë tabelare e stafit të angazhuar sipas kërkesës duke paraqitur edhe eksperienca, gjë e e cila mungon ne listen e prezentuar nga OE.

Prova 2. Pasqyra tabelare e personelit (Kërkesa sipas FTD-së)

2.Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 6 punetore).Në rast te grupit lideri duhet ti kete min 4 punetore.	**2.Një pasqyrë tabelare e personelit Emrin,Mbiemrin,Profesionin,Eksperienca dhe pozicioni të angazhuar me parakontrate ne kompani , duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga OE**

Prova 2. Pasqyra tabelare e personelit të paraqitura nga OE nuk është sipas specifikave të përshkruara në FTD.

ETM GROUP

LISTA E STAFIT

Nr.	Emri dhe mbiemri	Numri personal	Data e lindjes (dd/mm/vvvv)	Pozita
1	Irfan Kutllovci	1010684788	11.11.1965	Drejtor Gjeneral
2	Granit Kutllovci	1173203884	12.07.1992	Drejtor Menagjues

Paraqitur lista e prezentuar nga ky OE ITEM Group Shpk, mungojne shenimet e kerkuara sipas dosjes se tenderit, te hijezuara me te kuqe, ku perpos kesaj ky OE nuk ka prezentuar as kontratas e punes ose parakontrata me stafin e nevojshem min 6 punetore kerkuar sipas dosjes se tenderit, por ky OE ka prezentuar vetem dy kontrata andaj nuk permbush kriterin themelor te dosjes se tenderit, pasi qe me dy punetore nuk ka mundesi te realizohet edhe projekti sipas planit te kerkuar te punes referuar FTD-se.

Prezentojmë tutje faktin 3:

Tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:

3. OE duhet të emëroj menaxherin e projektit

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

3.OE në kuadër të stafit me vendim ose deklarate duhet të emëroj menaxherin e projektit i cili uhet të jet inxhinjer i i elektroteknikes ,me së paku tri vite përvojë pune në profesion e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën e punës ,të jet në listën e të punësuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi

Tek menaxheri i projektit eshte prezentuar, kontrata e punes dhe me poshte eshte prezentuar CV, e cila perfshine pervojen e punes ne kompanine ETM Group qe vertetohet me nje reference nga kjo kompani, por kjo refernece permbush vetem nje vit pervoje pune andaj nuk plotesohet kriteri qe te <ete 3 vite pervoje pune, kjo duke iu referuar deshmive nuk ka fakte te prezentuara mbi permbushjen e kriterit per pervojen e punes.

Prova 3. CV e prezentuar nga Menaxheri I Projektit per OE ETM GROUP SHPK



europass Curriculum Vitae Replace with First name(s) Surname(s)

INFORMATAT PERSONALE Smajl Smajlaj

Rr Jakov Xoxa, HY D nr 16 10000, Prishtina, Kosovo
+383 (0) 49 199 706 / +383 (0) 49 277 691
smajlmajlaj@hotmail.com

Sex : M | Date of birth 10/02/1987 | Nationality : Shqiptar

POZITA PËR TË CILËN APLIKONI Inxhinier i Elektros

PËRVOJA E PUNËS

01/10/2014-30/04/2015 **Inxhinier i Elektros – Project Manager**
-NTSH "Decon" Prishtine
-Mbikqyrje e Punimeve te trafostacioneve si dhe instalimeve civile

01/05/2015-30/08/2016 **Inxhinier i Elektros – Project Manager**
-NTSH "Eing" Prishtine
-Mbikqyrje dhe Projektim te Punimeve te trafostacioneve si dhe mbikqyrje e punimeve me njet te tensionit te mesem 10/20 kv si dhe te tensionit te ulet 0.4 kv

01/03/2017-31/12/2017 **Inxhinier i Elektros – Project Manager**
-"ETM GROUP SHPK, Prishtine
- Mbikqyrje dhe Projektim e Punimeve te trafostacioneve si dhe mbikqyrje e punimeve me njet te tensionit te mesem 10/20 kv si dhe te tensionit te ulet 0.4 kv



© European Union, 2002-2015 | europass.cedefop.europa.eu Page 1 / 3

europass Curriculum Vitae Replace with First name(s) Surname(s)

01 / 01 / 2018-31 / 01 / 2022 **Udheheqes I Inxhinjereve Mbikqyres**

-KEDS – Departament I Investimeve

-per 4 vite kam qene udheheqes I inxhinjereve mbiqkyres ne kuader te departamentit te investimeve ne KEDS, per projektet te cilat KEDS I implementon ne te gjithe Kosoven

01 / 02 / 2022-Ende **Inxhinier i Elektros – Project Manager**

-"TEK-ING" SHPK, Prishtine

- Mbikqyrje dhe Projektim e Punimeve te trafostacioneve si dhe mbikqyrje e punimeve me rrjet te tensionit te mesem 10/20 kv si dhe te tensionit te ulet 0-4 kv

EDUKIMI DHE TRAJNIMET

Siq është prezentuar, kemi mjaftueshem fakte se ky OE është I papërgjeshëm dhe se AK-ja ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore:

Shkelje e nenit 7 të LPP-së ne piken 1 dhe 2 : Trajtimi ne mënyre të barabartë dhe jo-diskriminuese

Neni 59 të LPP-së : Nuk është bërë ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimmi I tendereve conform këtij neni

Neni 60 të LPP-së: Kriteri kryesor për dhënie të kontratës ka qenë tenderi I përgjegjshëm me cmim më të lirë

Duke I analizuar të gjitha faktet e prezentuara, konkludojme që të gjithë këto OE janë të papërgjegjshëm dhe se *kompania PLUS TRADE LLC ka dorëzuar tenderin në përputhshëmri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit. Nga kjo, kërkojmë nga eksperti shqyrtues I OSHP-së, që të i konstatoj këto shkelje të AK-së dhe të I validojë këto shkelje dhe Paneli Shqyrtues I OSHP-së të detyrojë AK-në, që të respektoj kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe Njoftimin për kontratë dhe të veprojë konform dispozitave ligjore të Prokurimit Publik.*

Dhënia e kontratës OE të rekomanduar LABINOT KRASNIQI dhe Fati Security pa të drejtë na diskriminon ne pasi ne jemi të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët.

Andaj, ne si OE ankues, duke u bazuar ne provat e paraqitura si me larte, kerkojme nga OSHP-ja qe te merret paraysh kjo ankesë dhe të merr:

VENDIM

APROVOHETsi e bazuar ankesa e **OE. PLUS TRADE LLC**, dhe lenda te kthehetne

RIVLERESIM gjate rivleresimit te shperblehemi ne me kontrate pasi qe i plotesojme te gjithakriteret e Dosjes se Tenderit dlie te Njoftimit per Kontrate, pasi qe jemi OE i pergjegjshem me cmim me te lire, dhe OE i rekomanduar eshte i papergjegjshem dhe dy të tjerë OE ne radhe pasi qe nuk i plotesojne kriteret e kerkuara te FDT-se dhe te Njoftimit per kontrate/ Dosje te Tenderit, dhe ne si OE duhct te

SHPERBLEHEMI me kontrate per kete aktivitet pasi qe jemi OE i pergjegjshem me cmim me te lire dhe OE të tjere jane te papergjegjshem sipas kritereve te kerkuara te FDT-se.

KRITERET PËR VLERËSIM

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontrate në vlerë prej min. 180 000.00 euro.Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar furnizime te natyres se ngjajshme.	**1.Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkatese ose proceset e pranimeve per projektet e perfunduara – kopje.**
2.Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e	**2.Një pasqyrë tabelare e personelit**

B05 Njoftim per Kontrat 4 / 7

nevojshem që do të angazhohet në këtë projekt,(min. 6 punetore).Në rast te grupit lideri duhet ti kete min 4 punetore.	**Emrin,Mbiemrin,Profesionin,Eksperienca dhe pozicioni të angazhuar me parakontratë në kompani , duhet të dorëzohet në origjinal i nënshkruar dhe i vulosur nga OE**

3. OE duhet të emëroj menaxherin e projektit	**3.OE në kuadër të stafit me vendim ose deklarate duhet të emëroj menaxherin e projektit i cili duhet të jet inxhinjer i i elektroteknikes ,me së paku tri vite përvojë pune në profesion e dëshmuar me CV, diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën e punës ,të jet në listën e të punësuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi**
4.OE duhet te posedoj pajisjet teknike te nevojshme min. (një autoshport për ngritje në lartësi dhe min. një kamionet me mekanizëm të veqant (vinq) për ngritje të shtyllave në lartësi.	**4.Një listë të mjeteve apo pajisjeve teknike që janë në dispozicionin tuaj për të ekzekutuar kontratën në fjalë– pajisjet dhe makineria në dispozicion duhet të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësin e tyre , ose DUD-i doganor, ose fatura e blerjes ose kontrata mbi qiramarrjen- të dorëzohen në kopje të qartë dhe të lexueshme.**
5. OE duhet te ofroj Certifikaten ISO 9001 2015	**5.ISO 9001 2015 mbi sistemin e menaxhimit te cilesis - kopje me validitet**
6. OE duhet te ofroj certifikaten ISO 45001 2018	**6.ISO 45001 2018 sistemi per menaxhimin e siguris dhe shendetit ne pune – kopje me validitet.**
7. OE duhet te ofroj vleresimin e riskut nga nje kompani e licencuar nga MPMS , sipas Ligjit Nr.04L 161 per siguri dhe shendet ne pune .	**7. Deshmi kopja e certifikates per siguri dhe shendet ne pune e noterizuar nga origjinali per punetoret e angazhuar te certifikuar per siguri dhe shendete ne pune si dhe kopja e licences se bashku me raportin e vleresimit nga kompania e licencuar nga MPMS-ja.**

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues : Mirëmbajtja e ndriçimit publik në Komunën e Fushë Kosovës

Numri i aktivitetit te prokurimit: *Nr. I prokurimit: 612-23-13928 221*
Nr. i brendshëm: 612 23 072 221

Nr.	Emri dhe adresa e Operatorit Ekonomik	Vlera totale e ofertës
1	Grup i Operatorëve Ekonomik ANESI SH.P.K.; Elektrostublla	92 141.60
2	Grup i Operatorëve Ekonomik: N.N.P. " NDRIQIMI "; " Termovision " SH.P.K.	62 299.00
3	INLINE ENGINEERING SH.P.K.	79 255.00
4	Grup i Operatorëve Ekonomik Labinot M. Krasniqi B.I.; FATI SECURITY SH.P.K.	61 516.00
5	TONI INGJINJERING	82 937.00
6	" ETM Group " SH.P.K.	63 406.00
7	PLUS TRADE L.L.C.	77 097.50

9

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:
Komuna e Fushë Kosovës **shpërblen** me **kontratë** Grup i Operatorëve Ekonomik Labinot M. Krasniqi B.I.; FATI SECURITY SH.P.K.
"ne vlere totale te ofertës **61 516.00€**

Data : 09.01.2024
Emri dhe mbiemri i ZPP: Bedri Obertinca

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

N/A

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **PLUS TRADE L.L.C.**

Aktiviteti i prokurimit me titull: "**Mirëmbajtja e ndriçimit publik ne Komunën e Fushe Kosovës**" me nr. të prokurimit: **"612-23-13928-2-2-1"**, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues **(AK) – KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**, ka filluar me njoftimin për kontratë me datë 13.12.2023, hapja e ofertave është bërë me datë 26.12.2023, vendimi B58 publikohet me datë 10.01.2024.

OE ankuesi i pakënaqur me vendimin e AK-së, në cilin OE i rekomanduar shpallet GOE **Labinot M. Krasniqi B.I & Fati Security SHPK." Ndërsa OE ankuesi shpallet i pa suksesshëm,** tutje pas refuzimit të kërkesës për rishqyrtim, i njëjti parashtron ankesë në OSHP me datë 26.01.2024.

I njëjti në ankesë pretendon se AK nuk ka rivlerësuar ofertat konform LPP_së përkatësisht nenet: 1, 6, 7, 51, 59, 60, 61, 64, 69 dhe rregullores nr 001/2022 për prokurim publik .

Pretendimi i parë OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

OE ankuesi pretendon se lista e kontratave te realizuara te paraqitura nga GOE i rekomanduar për dhënie te kontratës nuk është sipas specifikave te përshkruara ne FDT.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues, sqaron se, në ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet lista e projekteve te ngjashme instalim dhe mirëmbajtje të ndriçimit publik mbi vlerën 180 000 euro me referenca, dhe si e tillë **pretendimi i OE ankues nuk gjendet i bazuar.**

Pretendimi i dytë OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Pasqyrat tabelore e stafit te angazhuar sipas kërkesës duke paraqitur edhe eksperienca, gjë e cila mungon ne listën e prezantuar nga GOE i rekomanduar.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues, sqaron se, në ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet lista e stafit, e cila përmban Emrin, Mbiemrin, Pozita, Profesioni, Data e lindjes, Nr Personal, kurse **eksperienca e stafit** si rubrike mungon në listë, të cilin konsideroj se AK mund ta vlerësoj konform nenit 59.4 të LPP-së duke e respektuar nenin 1 të LPP-së, andaj **pretendimi**

i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.

Pretendimi i tretë OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Tek menaxheri i projektit është prezantuar kontrata e punës e lidhur me datë 01.09.2022, dhe me poshtë në po të njëjtin file është prezantuar CV, e cila përfshinë përvojën e punës por për të mbështetur eksperiencën, kemi vetëm një vërtetim mbi këtë përvojë prezantuar vetëm nga vet kompania OE Labinot Krasniqi që është në konflikt interesi të vërtetohet përvoja e punës ku kontrata e punës është vetëm nga viti 01.09.2022 dhe nuk është prezantuar ndonjë kontratë tjetër ose çfarëdo dokumenti që do të kishte mbështetur CV-në e prezantuar. Duke iu referuar dëshmive dhe dokumenteve të ofruara nga OE e që I kemi pranuar nga AK-ja, nuk ka fakte të prezantuara mbi përmbushjen e kriterit për përvojën e punës.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues, sqaron se, në ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet kontrata e punës me afat të pa caktuar, po ashtu gjendet edhe në listat e deklaruara në ATK, posedon përvojën e punës, referencat, dhe si e tillë vërehet se i njëjti është I punësuar nga OE I rekomanduar mbi tri vite, gjithashtu pas sqarimeve nga AK, I njëjti ka bashkangjitur edhe përvojën e punës sipas CV-së nga kompania B. kontratën e punës dhe referencën, dhe si e tillë **pretendimi I OE ankues nuk gjendet I bazuar.**

Pretendimi i katërt OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Sipas kërkesës në FTD, pika 5 dhe 6,

5. OE duhet te ofroj Certifikatën ISO 9001 2015

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

5.IS0 9001 2015 mbi sistemin e menaxhimit te cilësisë - kopje me validitet

6. OE duhet te ofroj certifikatën ISO 45001 2018

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

6. ISO 45001 2018 sistemi për menaxhimin e sigurisë dhe shëndetit ne pune - kopje me validitet.

AK-ja në FTD ka kërkuar që të dorëzohen këto Certifikata me dosjen fillestare ashtu që të konsiderohet i përgjegjshëm dhe që i përmbush këto kritere për të vazhduar vlerësimin e ofertës në tërësi, por që në këtë rast, AK-ja ka vazhduar në kërkesë për plotësim të dosjes pas dorëzimit fillestar të bërë në e- prokurim me datë 26.12.2023, pasi ky GOE, nuk ka dorëzuar Certifikatën sipas pikës 6 të FTD-së

GOE ka dorëzuar (pas dorëzimit të ofertës fillestare) një dokument certifikatë referuar kërkesës Letër standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues, sqaron se, në ofertën e GOE te rekomanduarit gjendet ISO standardi 9001:2015 për Liderin e grupit, si dhe ISO 45001:2018 nga anëtari i konsorciumit, mirëpo AK konform rregullores **26 Grupi i Operatorëve Ekonomik** përkatësisht nenit 26.6 dhe 26.9, AK mund të sqaroj certifikatat në fjalë, si e tillë pretendimi i OE ankues **gjendet pjesërisht i bazuar.**

Citat" 26.6 Çertifkatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse

26.9 Nëse lënda e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshinë ofrimin e shërbimeve profesionale dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën, mjafton që njëri anëtar i grupit të ketë autorizimin, apo mjafton që njëri anëtar i grupit të jetë i licencuar dhe të dorëzoj dëshminë së bashku me dokumentet tjera të tenderit të grupit të operatorëve ekonomik në mënyrë që të konsiderohet se grupi e ka përmbushë këtë kërkesë si tërësi."

Pretendimi i pestë OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

AK-ja në DT ka kërkuar që Kopjet e certifikatave për siguri dhe shëndet në punë të jenë të noterizuara dhe të prezantohen të tilla.

Ne dosjen fillestare te dorëzuar ne e-prokurim mungojnë Kopjet e certifikatave për siguri dhe shëndet në punë të jenë të noterizuara , OE ka dorëzuar certifikata jo te noterizuara pas kërkesës nga AK-ja Letër standarde, ketë dëshmi e kemi edhe ne nga casja e marre ne AK. Por ne kërkesën tone për rishqyrtim, duke kontestuar këtë pike, AK-ja është përgjigjur qe AK-ja i ka kërkuar dëshmi shtese 9/3 dhe OE ja ka përcjellë pastaj te noterizuara, gjë që nuk janë këto certifikata të noterizuara në qasjen që e ka siguruar për kompaninë tonë vet AK-ja, gjë qe po aludohet që AK-ja pas kalimit te afatit ligjor për te plotësuar dosjen ose pas kërkesës sonë për rishqyrtim, i ka kërkuar prape dokumente shtese, duke e favorizuar pa te drejte dhe duke i dhëne mundësi te kompletoj dosjen pas kalimit të të gjitha afateve.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues, sqaron se, AK me datë 16 dhe 17.01.2024 ka kërkuar sqarime shtesë nga OE i rekomanduar, për të cilat i njëjti ka kthyer përgjigje dhe ka bashkangjitur dokumentet siç janë ISO 45001:2018, me certifikatat e noterizuara për 6 punëtorët e kërkuar minimum, mirëpo noterizimi ka datën **05.01.2024** gjerësa hapja e ofertave është bërë me datë **26.12.2023, pra noterizimi është bërë pas hapjes së ofertave, gjë që paraqet ndryshim material në ofertë, andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Pretendimi i gjashtë OE ankues kundër OE të rekomanduarit:

Referuar edhe çmimeve te ofertuar, ky grup i OE, ka ofertuar me çmime jo normalisht te ulëta,

Siç shihet edhe nga oferta për pozicionet si: 3, 5 6 dhe 17 ky OE ka përdorur çmime manipulative te cilat edhe shume lehte janë te verifikueshme ne treg, ku NE ofrojmë dëshminë mbi çmimet e furnizimit te cilat janë te papranueshme se si i ka paraqitur OE Labinot Krasniqi dhe Fati Security.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e OE ankues, sqaron se, AK lidhur me pozicionet në paramasë, nuk ka kërkuar sqarime konform nenit 41 të rregullores për prokurim publik, si e tillë gjatë procesit të rivlerësimit AK mund të kërkoj sqarime shtesë lidhur me çmimet inter partes.

Tutje, OE ankuesi ka parashtruar gjithashtu pretendime ankimore edhe për dy operator ekonomik tjerë.

Pretendimi i parë i OE ankues kundër GOE Ndriqimi dhe Termovision:

Lista e kontratave të realizuara të paraqitura nga GOE nuk është sipas specifikave të përshkruara në FTD.

Referuar edhe vlerës se kërkuar te kontratave për 3 vitet e fundit OE Ndriçimi nuk ka referenca ose pranime te punëve ne vlerën e kërkuar si dhe anëtari tjetër Termovision te gjitha kontratat i ka te natyrës se mirëmbajtës se nxehjeve dhe ngrohjes qendrore, andaj edhe nuk është ne natyrën e punës se kërkuar nga AK, andaj ky grup nuk përmbush as piken kryesore te dosjes se tenderit.

Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e parë të OE ankues kundër GOE Ndriçimi dhe Termovision sqaron se, në ofertën e GOE në fjalë gjendet lista e projekteve, ku lideri posedon thuajse të gjitha projektet mirëmbajtje e ndriçimit publik, të cilat disa kanë referenca, mirëpo conform nenit 72 të LPP_së, AK në rivlerësim mund të kërkoj sqarime, andaj pretendimi I OE ankues **gjendet pjesërisht I bazuar.**

Pretendimi i dytë i OE ankues kundër GOE Ndriçimi dhe Termovision:

Tek menaxheri i projektit është prezantuar, kontrata e punës dhe me poshtë është prezantuar CV, e cila përfshinë përvojën e punës ne kompaninë IBITS qe vërtetohet me një reference nga kjo kompani e cila nuk ka date te lëshimit te referencës, andaj nuk mundemi edhe te validojme se për cilën periudhë po vërtetohet përvoja e punës, por nëse shikohet pershkrimi i punes ne CV, kjo kompani nuk ka ketë natyre te punës, referuar aktiviteteve te përshkruar ne webin https://arbk.rks-gov.net/

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues kundër GOE Ndriçimi dhe Termovision sqaron se, OE në fjalë e posedon menaxherin e projektit i cili ka të bashkangjitur kontratën e punës, CV, dhe referenca/vërtetimi e cila në brendi shkruan që ka filluar punën nga shtatori 2019, e cila përkon me datën në CV, ndërsa sa i përket vërtetimit, mund të vërtetohet nga

kompania, andaj si e tillë **pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar.**

Pretendimi i tretë i OE ankues kundër GOE Ndriçimi dhe Termovision:

Referuar kësaj pike, te gjithë anëtaret nuk janë te përshtatshëm pasi qe nuk kane prezantuar dëshminë për përshtatshmërinë e tyre konform dosjes se tenderit, andaj referuar certifikatës ISO sipas pikës 5 dhe 6 OE NNP Ndriçimi nuk përmbush këtë kriter, andaj nuk mundet te sigurohet qe ky OE i propozuar mund te ofroj realizimin e kontratës sipas standardeve te kërkuara. OE NNP Ndriçimi është lideri i grupit ne këtë rast ndërsa ky OE nuk është i certifikuar sipas kërkesës pikës 5 dhe 6 te FTD-se.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e tretë të OE ankues kundër GOE Ndriçimi dhe Termovision sqaron se, në ofertën e OE në fjalë gjendet ISO standardi 9001:2015, 1400:2015 dhe 45001:2018 nga Termovision Shpk, mirëpo konform rregullores 001/2022 për prokurim publik neni **26 Grupi i Operatorëve Ekonomik** përkatësisht nenit 26.6 dhe 26.9, AK duhet të sqaroj certifikatat në fjalë, si e tillë pretendimi i OE ankues **gjendet pjesërisht i bazuar.**

Citat" 26.6 Certifikatat për sigurimin e cilësisë, përmenden në nenin 70 të LPP-së dhe kanë për qëllim vërtetimin e përputhshmërisë së operatorit ekonomik me një numër të caktuar standardesh për sigurimin e cilësisë. Nëse Autoriteti Kontraktues kërkon çertifkata të hartuara nga organe të pavarura që kryejnë aktivitete të certifikimit për të vërtetuar se operatori ekonomik përmbush standarde të caktuara për sigurimin e cilësisë që bazohen në standarde kosovare, evropiane ose ndërkombëtare, secili anëtar i grupit do të dëshmoj se i përmbush standardet përkatëse

26.9 Nëse lënda e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshinë ofrimin e shërbimeve profesionale dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën, mjafton që njëri anëtar i grupit të ketë autorizimin, apo mjafton që njëri anëtar i grupit të jetë i licencuar dhe të dorëzoj dëshminë së bashku me dokumentet tjera të tenderit të grupit të operatorëve ekonomik në mënyrë që të konsiderohet se grupi e ka përmbushë këtë kërkesë si tërësi."

Pretendimi i katërt i OE ankues kundër GOE Ndriçimi dhe Termovision:

Referuar edhe çmimeve te ofertuar, ky grup i OE, ka ofertuar me çmime jo normalisht te ulëta,

Ne baze te Ofertës se prezantuar shihet qarte se OE ne shumicën e pozicioneve ka çmim jo normalisht te ulet. Ne baze te kësaj mendojmë se AK ka vepruar ne kundërshtim me nenin 61 te LPP- se dhe te nenit 41 te Rregullore 001/2022. Neni 41 Tenderët Jo-normalisht të Ulët, pasi nuk ka kërkuar sqarime shtesë dhe zbërthim të kostos financiare për këto pozicione:

Siç shihet edhe nga oferta për pozicionet si: 3,5,6,7,22,dhe 23 ky OE ka përdorur çmime manipulative te cilat edhe shume lehte janë te verifikueshme ne treg, ku NE dëshmojmë mbi çmimet e furnizimit te cilat janë te papranueshme se si i ka paraqitur OE NNP Ndriçimi dhe Termovision.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e katërt të OE ankues kundër GOE Ndriçimi dhe Termovision sqaron se, paramasa me çmime inter partes konsideroj se AK konform rregullores për

prokurim publik neni 41 duhet të kërkoj sqarime shtesë për pozicionet e pretenduara nga OE ankuesi, andaj **pretendimi i OE ankues gjendet pjesërisht i bazuar.**

Tutje, pretendimet e OE ankues kundër operatorit ekonomik **ETM GROUP SHPK**

Duke krahasuar kërkesat në DT dhe ofertën e dorëzuar nga **OE ETM GROUP SHPK,** kemi vërejtur që oferta e tyre nuk përmbush këto specifikime teknike: Bazuar ne Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2:

Pretendimi i parë i OE ankues kundër ETM GROUP SHPK:

Referuar edhe vlerës se kërkuar te kontratave për 3 vitet e fundit ky OE ETM Group nuk ka referenca ose pranime te punëve ne vlerën e kërkuar qe dëshmojnë pranimin ose përfundimin e kontratave ose punëve te kësaj natyre te kërkuar për ndriçimin publik, kontratat e përfunduara nuk kane pranime teknike ose referenca andaj nuk konsiderohen te përfunduara dhe si baze andaj ky grup nuk përmbush as piken kryesore te dosjes se tenderit.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e parë të OE ankues kundër **OE ETM Group Shpk** sqaron se, në ofertën e OE në fjalë gjendet lista e projekteve e cila posedon projekte të ndriçimi publik, mirëpo nuk i posedon të gjitha me referenca, dhe si e tillë, AK në rivlerësim mund ti sqaroj konform nenit 72 të LPP-së, **pretendimi gjendet pjesërisht i bazuar.**

Pretendimi i dytë i OE ankues kundër ETM GROUP SHPK:

Po ashtu tek pika 2, është kërkuar të prezantohet një pasqyrë tabelore e stafit të angazhuar sipas kërkesës duke paraqitur edhe eksperienca, gjë e cila mungon ne listën e prezantuar nga OE.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë të OE ankues kundër OE ETM Group Shpk sqaron se, në ofertën e OE në fjalë gjendet lista e stafit e cila përmban Emrin, Mbiemrin, Datën e lindjes, Pozita dhe nr personal, kurse eksperienca nuk është e cekur në listë konform kërkesës së AK-së DT, mirëpo AK mund ta vlerësoj konform nenit 59.4 të LPP-së, si e tillë pretendimi i OE ankues **gjendet pjesërisht i bazuar.**

Pretendimi i tretë i OE ankues kundër ETM GROUP SHPK:

Tek menaxheri i projektit është prezantuar, kontrata e punës dhe me poshtë është prezantuar CV, e cila përfshinë përvojën e punës ne kompaninë ETM Group që vërtetohet me një reference nga kjo kompani, por kjo referencë përmbush vetëm një vit përvoje pune andaj nuk plotësohet kriteri qe te ketë 3 vite përvojë pune, kjo duke iu referuar dëshmive nuk ka fakte te prezantuara mbi përmbushjen e kriterit për përvojën e punës.

Ekspertja Shqyrtuese lidhur me pretendimin e parë të OE ankues kundër OE ETM Group Shpk sqaron

se, në ofertën e OE në fjalë gjendet menaxheri i projektit i cili e posedon referencën ku shkruan se është i angazhuar në projekte prej datës 01.10.2016, ndërsa në CV shkruan qe në kompaninë ETM ka punuar nga 01.03.2017-31.12.2017, ndërsa aktualisht punon prej datës 01.02.2022 në TEK-ING SHPK-mbikëqyrje dhe projektim , si e tillë konsideroj se AK mund ta sqaroj përvojën e punës në rivlerësim, pretendimi i OE ankues **gjendet pjesërisht i bazuar.**

CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund të kërkohen informata sqaruese	69
CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos	Mund të kërkohen informata sqaruese	69

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **PLUS TRADE L.L.C.**

Blerina Huruglica